VENDIM
Nr. 133, datë 7.6.2018

MBI KËRKESËN E SHOQËRISË "ÇAUSHI - ENERGJI" SHPK PËR MODIFIKIMIN E LICENCËS SË "PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE" NR. 181, SERIA PV12K, TË MIRATUAR ME VENDIMIN E BORDIT TË KOMISIONERËVE TË ERE-s NR. 122, DATË 29.8.2012

Në mbështetje të neneve 16 dhe 43, të ligjit nr. 43/2015, "Për sektorin e energjisë elektrike", i ndryshuar; VKM-së nr. 365, datë 4.5.2011 "Marrëveshje Kocensionare me nr. 5446 rep; nr. 1944 kol, datë 2.5.2011", të ndryshuar; nenit 15 të "Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike", miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 109, datë 29.6.2016; nenit 15 të "Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s", miratuar me vendimin e bordit nr. 96, datë 17.6.2016, bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 7.6.2018, mbasi shqyrtoi relacionin për modifikimin e licencës së shoqërisë "Çaushi - Energji" sh.p.k., përgatitur nga Drejtoria e Licencimit dhe e Monitorimit të Tregut,

konstatoi se

- Shoqëria "Çaushi - Energji" sh.p.k. është licencuar në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC "Qafëzezë", me fuqi të instaluar 400 kw, me vendimin e bordit të ERE-s nr. 122, datë 29.8.2012.

- Me shkresën me nr. 312 prot., datë 11.4.2018, shoqëria "Çaushi - Energji" sh.p.k., ka paraqitur në ERE një kërkesë për modifikimin e licencës aktuale nr. 181, seria PV12K për "Prodhimin e energjisë elektrike" nga HEC "Qafëzezë", me fuqi të instaluar 400 kw, të miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s nr. 122, datë 29.8.2012.

- ERE, me vendimin nr. 95, datë 20.4.2018, vendosi fillimin e procedurave, "Për modifikimin e licencës së shoqërisë "Çaushi -Energji" sh.p.k.", me nr. 181, seria PV12K për "Prodhimin e energjisë elektrike" nga HEC "Qafëzezë", me fuqi të instaluar 400 kw.

Dokumentacioni i depozituar në ERE nga shoqëria "Çaushi - Energji" sh.p.k., në bazë të "Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike", rezulton si më poshtë:

- Informacioni me shkrim ku janë shpjeguar arsyet e kërkesës për modifikimin e licencës (neni 15, pika 4, germa "a"), është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.

- Vendimi me shkrim i organeve drejtuese të të licencuarit, të cilat shprehin vullnetin për të kërkuar modifikim licence (neni 15, pika 4, germa "b"), është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.

- Miratimi i modifikimit të parametrave dhe kushteve të tjera të licencës kur këto janë të kushtëzuara me miratimin nga organe të tjera (neni 15, pika 4, germa "c"). Aplikuesi ka paraqitur: kontratë shtesë, "Për disa ndryshime dhe shtesa në kontratën e koncesionit (nr. 2452 rep., nr. 307 kol., datë 24.7.2009) të formës "BOT", për ndërtimin e HEC "Qafëzezë ", mbajtur në datën 21.2.2017, me nr. 529 rep., nr. 201/1 kol., midis MEI-t si autoritet kontraktues dhe shoqërisë "CAUSHI/K" sh.p.k. me cilësinë e koncesionarit.

- Ndikimet e pritshme të modifikimit të licencës ndaj detyrimeve të të licencuarit sipas legjislacionit në fuqi (neni 15, pika 4, germa "d"), janë paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.

- Plotësimi i pagesave të rregullimit në ERE (neni 15, pika 4, germa "e"), është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.

- Nuk janë paraqitur nga subjekti leja mjedisore dhe leja e shfrytëzimit të ujërave, të lëshuara nga organet kompetente për fuqinë e instaluar 1450 kw.

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Pranimin e kërkesës së shoqërisë "Çaushi - Energji" sh.p.k., për modifikimin e licencës me nr. 181,

seria PV12K, për "Prodhimin e energjisë elektrike" nga HEC "Qafëzezë", me fuqi të instaluar 400 kw, të miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s nr. 122, datë 29.8.2012, me kushtin që brenda 3 muajve nga marrja dijeni e këtij vendimi, të depozitojë në ERE lejen mjedisore dhe lejen e shfrytëzimit të ujërave, të lëshuara nga organet kompetente për fuqinë e instaluar 1450 kw.

2. Në rastin e mospërmbushjes së këtij kushti nga ana e subjektit, ERE rezervon të drejtën e rishikimit të këtij vendimi.

3. Fuqia e instaluar në HEC-in "Qafëzezë", nga 400 kw bëhet 1450 kw.

4. Drejtoria e Licencimit dhe e Monitorimit të Tregut të njoftojë aplikuesin për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim mund të ankimohet në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga botimi në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Petrit Ahmeti